



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA VENDORE E PËRMBARIMIT LUSHNJE



Nr.59/11 Prot
Nr.422 Regj

Lushnje, më 01.04.2025

VENDIM –SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 01.04.2025,

Unë Brikena Luto, me detyrë Kryetar i Zyrës Vendore të Përmbarrimit Lushnje, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarrimore nr.422 bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit nr.280 (64-2022-1843), datë 03.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 24.01.2025 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarrimit Lushnje kërkesa e kreditorit së bashku me “Urdhërin e Ekzekutimit” të vendimit nr.15 (50), datë 17.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje lënë në fuqi me vendimin nr.396 , datë 06.04.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë me palë:

- Kreditor: Klei Ferdinand Kadiu, Alendo Ferdinand Kadiu dhe Arta Bezat Haxhiu
- Debitor : Kristaq Hekuran Hysenaj, Ramazan Sako Kashari, Albert Gori Koçi, Feçorr Ymer Kiptiu, Vangjel Xhaferr Ferracaku, Maksim Tili Ferracaku
- Me objekt: Lirim dorzim sendi dhe kthim shume

Nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8, datë 02.02.2023 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror*”, për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitorët Kristaq Hekuran Hysenaj dhe Albert Gori Koçi nuk kanë marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proedurës Civile dhe ligjit nr.8, datë 02.02.2023 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor*.”

VENDOSA:

- Të kryejë njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditë (duke marrë parasysh edhe komunimin postar), nga data 02.04.2025 – 22.04.2025 të debitorit Kristaq Hekuran Hysenaj dhe Albert Gori Koçi
 - Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim nga ana e punonjësve të Bashkisë Lushnje pranë banesës së fundit të palëve debitoare Kristaq Hekuran Hysenaj me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Veli Haxhiu”, Nd.5, H.1, Kodi Postar 9001, Lushnje dhe Albert Gori Koçi me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Hekuran Zhiti”, Nd.76, H.1, Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, një kopje dërgohet për afishim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithëshme të Përmbarimit Tiranë.
1. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palët debitoare Kristaq Hekuran Hysenaj me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Veli Haxhiu”, Nd.5, H.1, Kodi Postar 9001, Lushnje dhe Albert Gori Koçi me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Hekuran Zhiti”, Nd.76, H.1, Lushnje
 2. Palët debitoare Kristaq Hekuran Hysenaj me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Veli Haxhiu”, Nd.5, H.1, Kodi Postar 9001, Lushnje dhe Albert Gori Koçi me adresë lagja “18 Tetori”, rruga “Hekuran Zhiti”, Nd.76, H.1, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës Vendore të Përmbarimit Lushnje në lagjen “Kongresi i Lushnjes”, rruga “Vojo Kushi”, pallati mbrapa kinoteatrit “Vaçe Zela” kati II dhe të marrë kontakte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e në vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 01.04.2025

KRYTAR I ZYRËS

Brikena Luto